



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 22.8.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË**  
**OBILIQIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Sylaj, Udhëheqës Ekipi dhe Anëtarët Syeda Oruqi dhe Ardita Salihu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
5 Qeverisja e mirë.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	29
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	31
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	40

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës së Obiliqit për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksim i Çështjes**

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se informatat e shpalosura në Pasqyrat Financiare Vjetore në lidhje me pasuritë nuk janë të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e komunës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e saj se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes**

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### **Baza për opinion**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

## Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Vlera e pasurive të regjistruara në PFV nuk ishte e plotë, pasi që komuna ende nuk kishte regjistruar të gjitha tokat në pronësi të komunës;
- Pasuria e blerë në vitin 2017 në vlerë 202,806€ nuk është regjistruar në regjistrat kontabël të pasurisë. Kjo vlerë kishte të bënte me projektet, “Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuareve”, “Rregullimi i parqeve”, një pjesë e “Ndërtimit të shkollës në Lajthishtë” dhe “Shtruarja e rrugëve me zhavorr; dhe
- Objekti i ri komunal, në të cilën është e vendosur administrata komunale e cila ishte donacion, nuk është regjistruar si pasuri komunale.

Shpalosjet e pasakta ishin për shkak të mungesës së qasjes adekuate për të menaxhuar pasuritë dhe shpenzimet konform rregullave të aplikueshme. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

## Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Obiliqit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo

---



gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e ligjeve Organike për Qeverisje Lokale;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Raportet tremujore duke përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë;
- Raportet dhe faturat e papaguara; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin për kontratat e nënshkruara publike.

Në kontekst të PFV-ve, këshillat që i kemi dhënë në Memorandumin e Auditimit ishin adresuar gjatë procesit të përgatitjes së tyre. Por sfidë edhe më tutje mbetet angazhimi i Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF).

Në draft PFV fillestare kishte disa gabime, mirëpo gjatë kohës së auditimit ato janë korrigjuar. Megjithatë, në PFV-të finale nuk janë shpalosur drejtë informatat për pasuritë të cilat janë përmendur te Theksimi i çështjes te opinionit të auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Sa i përket kërkesave tjera për raportim të jashtëm, komuna nuk ka arritur të dorëzojë në Ministrinë e Financave (MF) raportin e detajuar tremujor për progresin e investime kapitale.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura ne japim rekomandimin si në vijim:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se janë analizuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për ta konfirmuar menaxhimin dhe regjistrimin e plotë të pasurisë, përfshirë edhe shpalosjen e drejtë të tyre në PFV.

Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Obiliqit kishte shpenzuar 91% të buxhetit final për vitin 2017, që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm, megjithëse sfidë mbetet niveli i realizimit të investimet kapitale. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë të vendosura, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në inkasimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe. Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>6,061,079</b>	<b>6,437,696</b>	<b>5,870,255</b>	<b>5,526,498</b>	<b>5,511,351</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,016,366	5,128,812	5,090,813	4,546,596	4,241,691
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> -	-	161,488	133,548	315,585	515,298
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	1,044,713	1,044,713	548,797	648,276	725,279
Donacionet e brendshme	-	11,428	5,842	10,840	7,738
Donacionet e jashtme	-	91,255	91,255	5,201	21,345

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 6% apo 376,617€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 161,488€ e cila bartje ishte aprovuar nga Kuvendi Komunal në shkurt të vitit 2017. Po ashtu, me vendim të Qeverisë, në dhjetor, buxhetit i janë shtuar 112,466€ për mbulimin e disa projekteve. Komuna kishte përfituar edhe donacione të jashtme dhe

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

të brendshme në vlerë 102,683€, të cilat ishin alokuar kryesisht për të financuar sektorin e bujqësisë. Ndërkohë që shpenzimi nga grantet (përfshirë ato të bartura nga viti kaluar) ishte 97,098€, diferenca e bartur për 2018 ishte 5,585€, performancë kjo mjaft e mirë.

Për vitin auditues, komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final, që konsiderohet një performancë e mirë e buxhetit, mirëpo krahasuar me vitin e kaluar ka një rënie në shkallën e realizimit për 4%. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>6,061,079</b>	<b>6,437,696</b>	<b>5,870,255</b>	<b>5,526,498</b>	<b>5,511,351</b>
Pagat dhe Mëditjet	3,664,936	3,709,367	3,695,367	3,673,058	3,529,492
Mallrat dhe Shërbimet	367,452	383,724	350,052	372,479	437,866
Shërbimet komunale	123,000	176,017	167,628	116,453	126,974
Subvencionet dhe Transferet	138,799	140,558	135,981	133,127	165,009
Investimet Kapitale	1,766,892	2,028,030	1,521,227	1,231,381	1,252,010

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për 261,138€ si rezultat i të hyrave vetanake të vitit të kaluar si dhe granteve të përcaktuara te donatorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Pavarësisht rritjes së buxhetit, vetëm 75% e buxhetit të investimeve ishte shpenzuar. Vlen të theksohet se PIP përfshinë 22 projekte, nga të cilat vetëm projekti për Hartën Zonale nuk kishte arritur të fillojë për shkak të vonesave në përgatitje për përpilimin e saj;
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte rritur përmes buxhetit që është alokuar nga granti qeveritar për 44,431€, për të mbuluar deficitin e buxhetor të kësaj kategorie;
- Me rishikim të buxhetit, kategoria e mallrave dhe shërbimeve kishte rritje të buxhetit në vlerë prej 16,272€;
- Buxheti final për shpenzimet komunale ka ndryshuar nga ai fillestar për 53,017€ dhe i njëjti ishte shpenzuar në shkallën 95%. Kjo kategori ka pësuar ndryshime më të mëdha mes vitesh si rezultat i investimeve të mëdha tek ndriçimi publik. Kjo ka shkaktuar rritje të shpenzimeve komunale (shpenzime të rrymës). Duhet të cekim se edhe pse ky buxhet ishte rritur, komuna sërish nuk ka arritur të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe si rezultat i kësaj, shpenzimet prej 27,065€ janë kryer përmes përmbaruesit; dhe
- Kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishte rritur për 1,759€, e cila shumë ka rrjedhë nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar, me vendimin e Kuvendit Komunal, me qëllim të subvencionimit të personave individual, bursa të studentëve dhe nxënësve, aktiviteteve kulturore, etj.

---

**Çështja 2 – Realizimi i buxhetit dhe keq-klasifikimi i shpenzimeve**

**E gjetura** Shkalla aktuale e ekzekutimi të buxhetit për investimet kapitale është sfida kryesore me të cilën përballet komuna. Një përqindje e madhe e shpenzimeve është koncentruar në tremujorin e fundit, dhe përsëri vetëm 75% e buxhetit të kësaj kategorie është shpenzuar. Kjo ishte si rezultat i planifikimit jo të mirë të shpenzimeve në këtë kategori. Sipas zyrtarëve komunal, në vitin 2017 nuk kishte rishikim të buxhetit, andaj nuk kanë mundur të ri destinohen mjetet dhe kanë mbetur të pa shpenzuara.

Po ashtu, pagesa në vlerë 5,396€ për blerje të veglave dhe renovime të disa institucioneve shkollore, ishin paguar nga investimet kapitale edhe pse për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave, gjithashtu nga investimet kapitale përmes përmbaruesit ishte paguar edhe fatura e rrymës me vlerë 27,065€, të cilat kanë rritur përqindjen e realizimit.

**Rreziku** Ekzekutimi i ulët i buxhetit tek investimeve kapitale do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion. Për komunën mos-përmbushja e programit për investimet kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve të cilat ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve si dhe në cilësinë e shërbimeve. Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

**Rekomandimi 2** Kryetari, duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit tek investimet kapitale në 2017 si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Ndërsa, planifikimi dhe shpenzimi për projekteve të caktuara duhet të bëhet konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.

### Çështja 3 – Pagesa direkt nga Thesari

- E gjetura** Sipas nenit 39.2 dhe 40 të LMFP-së, Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 70,423€ nga buxheti i komunës direkt në llogari të Operatorit Ekonomik (OE). Punët ishin të përfunduara, mirëpo nuk ishin paguar sipas procedurave të rregullta për shpenzimin e parave publike. Kjo ka ndodhur si rezultat i planifikimit jo të mirë të nevojave dhe mjeteve për realizimin e tyre. Ekzekutimi i këtyre pagesave kishte shkaktuar shpenzime shtesë për 9,460€.
- Rreziku** Format e pagesës përmes vendimeve gjyqësore, rrezikojnë realizimin e projekteve të planifikuara kapitale apo realizimit të shërbimeve nga ku janë marrë mjetet për pagesë. Po ashtu pagesat e tilla mund të shkaktojnë dëmtim shtesë të buxhetit për shkak të shpenzimeve përmbare.
- Rekomandimi 3** Kryetari, duhet të siguroj kontrollë, përgjegjshmëri më të lartë ndaj kryerjes së obligimeve me kohë ndaj operatorëve, si dhe të shmang hyrjen në obligime në mungesë të mjeteve apo kontratës. Gjithashtu, gjatë planifikimit buxhetor, të bëhet një vlerësim i shumave të mundshme të daljes së parasë nga kontestet gjyqësore dhe këto të planifikohen në kuadër të buxhetit vjetor, në mënyrë që mos të rrezikohet realizimi i projekteve tjera të planifikuara.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 891,848€. Në këtë vlerë, të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 37%, ndërsa pjesën tjetër të hyrat, si: të hyrat për ndërrim destinimi të shfrytëzimit të tokës, taksa për ushtrimin e veprimtarisë, taksa për regjistrimin e trashëgimisë, lejet e ndërtimit etj. Po ashtu komuna këtë vit ka pranuar edhe të hyra prej gjobave nga trafiku dhe gjykatat në vlerë prej 25,619€ të cilat janë shpalosur në PFV.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
<b>Gjithsej të hyrat vetjake</b>	<b>1,044,713</b>	<b>1,044,713</b>	<b>891,848</b>	<b>782,798</b>	<b>1,043,717</b>
Tatimi në pronë	366,984	366,984	333,395	328,871	320,244
Taksa komunale	677,729	677,729	558,453	453,926	723,473

Në vitin 2017 nga të hyrat vetjake ishin shpenzuar 682,345€<sup>4</sup>, derisa vlera prej 396,610€ është bartur për tu shpenzuar në vitin 2018. Nga të hyrat vetanake mbulohen një pjesë e shpenzimeve, kryesisht të hyrat vetanake destinohen për projekte kapitale, ku 503,728€ ishin shpenzuar për investime kapitale.

<sup>4</sup> 548,797€ nga të hyrat e vitit aktual dhe 133,548€ nga të hyrat e vitit të kaluar.

---

Gjatë auditimit për mënyrën e menaxhimit të të hyrave në komunë ne kemi vërejtur disa mangësi që do t'i paraqesim në vijim.

---

#### **Çështja 4 - Mos verifikimi 1/3-tës së pronave të komunës**

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe UA në fuqi. Nga gjithsej 5,813 prona deri më tani komuna ka arrit të verifikoj vetëm rreth 610 sosh. Sipas zyrtarëve verifikimi i 1/3 së pronave është një gjë e pamundur për shkak të numrit të vogël të stafit.
- Rreziku** Mos përditësimi i të dhënave që lidhet edhe me verifikimin e 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.
- Rekomandimi 4** Kryetari, duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-tës së pronave bëhet në baza të rregullta vjetore, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

#### **Çështja 5 - Vonesat në definimin e pronësisë**

- E gjetura** Gjatë auditimit kemi konstatuar disa probleme lidhur me menaxhimin e objektit "D" dhe "GJ", në të cilin janë 32 banesa dhe 9 lokale. Këto objekte gjenden në qendër të qytetit dhe sipas rregullores, baza e tatimit në pronë do të duhej të ishte 320€/m<sup>2</sup>. Total i sipërfaqes së të gjitha banesave është 2,106m<sup>2</sup>.
- Komuna i kishte shitur banesat në vitin 2015 të cilat deri në këtë periudhë ishin shfrytëzuar me qira. Edhe pse shitja kishte ndodhur, pronat nuk ishin transferuar te pronarët e ri dhe si pasojë komuna nuk po arrin të vjelë të hyra nga tatimi në pronë.
- Sa i përket lokaleve, kjo çështje është trajtuar në auditimin e vitit 2016 dhe është cekur tek pjesa e rekomandimeve të vitit paraprak.
- Rreziku** Mos definimi i pronësisë me kohë, rrezikon që të hyrat që do të duhej inkasuar nga tatimi në pronë nuk do të realizohen dhe kjo do të ndikonte direkt në buxhetin e komunës.
- Rekomandimi 5** Kryetari, duhet të sigurojë që komuna si shitëse e banesave në përmbushje të dispozitave të ligjit 04/L061 të sqarojë me autoritetet relevante çështjen e pronësisë së banesave dhe të përmbyllë procesin e bartjes së pronësisë tek pronarët e rinj. Po ashtu, të aplikoj procedurat e nevojshme për regjistrimin e pronarëve në sistemin e tatimit në pronë.

---

## Çështja 6 - Ngecjet tek të hyrat nga qiraja

- E gjetura** Ne kemi vërejtur se:
- Komuna në vitin 2014 i kishte dhënë operatorit ekonomik pëlqim për shfrytëzim të hapësirës për vendosje të reklamave, mirëpo e njëjta nuk i ka paguar obligimet që ka ndaj komunës. Obligimet janë përcaktuar për tarifën vjetore prej 900€ të cilën nuk e ka paguar deri më tani. Në pikën IV të pëlqimit, theksohet se çdo mosrespektim i pëlqimit sanksionohet me gjoba, gjë e cila nuk kishte ndodhur, derisa në vitin 2017 nuk i është tërhequr as vërejtja për mos pagesë; dhe
  - Nga testimi i katër kontratave të qirasë për lokale afariste, komuna nuk realizon të hyrat për të cilat ka nënshkruar kontratë. Të njëjtëve nuk i është ndërprerë kontrata, personat vazhdojnë të shfrytëzojnë të njëjtat prona, derisa komuna nuk iu kishte shpërndarë asnjë vërejtje. Borxhi i tyre është 2,192€.
- Rreziku** Menaxhimi i dobët i hapësirave publike dhe i kontratave të qirave rezulton në rritjen e të arkëtueshmeve si dhe ka shkaktuar rritjen e papërgjegjshmërisë së qytetarëve të cilët shfrytëzojnë pronat publike duke mos kryer obligimin që kanë ndaj tyre.
- Rekomandimi 6** Kryetari, duhet të siguroj se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet dhe keqpërdoret pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma që të merren masa të menjëhershme që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.

## Çështja 7 - Mos aplikimi i taksës adekuate

- E gjetura** Sipas rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba, për ndërrimin e destinimit të tokës së klasës I-IV, taksa është e përcaktuar 1€/m<sup>2</sup>, ndërsa komuna nuk ka aplikuar taksën adekuate për pagesë, pasi që për të njëjtin qëllim, komuna kishte faturuar obliguesin me taksë 0,75€/m<sup>2</sup>.
- Rreziku** Mangësitë në procesin e përcaktimit të taksës adekuate për mbledhjen e të hyrave, mund të dëmtojnë këtë proces dhe të shkaktojnë humbje financiare apo të hyra më të vogla për komunën, siç edhe ka ndodhur.
- Rekomandimi 7** Kryetari, duhet të sigurojë që kriteret për tarifën e përcaktuara në rregullore duhet të zbatohen sipas rasteve përkatëse, në mënyrë që të hyrat të arkëtohen në kohën dhe mënyrën e duhur, duke u qartësuar ngarkesat që iu takojnë obliguesve.



### 3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payroll) që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: kontrollin e pagesave, nënshkrimin e listave të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, azhurnimin e dosjeve të personelit si dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për vitin 2017 buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 3,709,367€ me një shpenzim prej 3,695,367€, duke rezultuar me një realizim të tërësishëm të buxhetit.

Testet tona kanë vënë në pah mangësitë si në vijim:

#### Çështja 8 - Kompensimi i pagave dhe harmonizimi i koeficienteve

**E gjetura** Kemi vërejtur se një pjesë e konsiderueshme e stafit komunal kompensohet me koeficientë më të ulët krahasuar me pozitat ekuivalente të organizatave tjera lokale apo koeficientët e tyre janë më të ultë se sa u garantohen me ligjet dhe vendimet përkatëse, ndër të tjerash:

- Menaxheri i prokurimit paguhet me koeficientin 7.5 edhe pse që nga qershori 2015 ka të nënshkruar akt-emërimin me koeficient 9.5; dhe
- Sipas vendimit për unifikim të pagave të bërë nga MAP, datë 03.12.2010 auditori i brendshëm duhet të kompensohet me koeficientin 15, ndërsa aktualisht ka koeficientin 7.

**Rreziku** Kompensimi jo i drejtë i punonjësve, sjellë demotivim të tyre duke rrezikuar të ofrohet një shërbim jo cilësor ndaj qytetarëve. Përveç kësaj, komuna mund të jetë subjekt i kontesteve gjyqësore.

**Rekomandimi 8** Kryetari, duhet të sigurojë se Zyra e Burimeve Njerëzore dhe ajo e Financave kanë ndërmarrë hapat e duhur dhe në bashkëpunim me MAP-in të harmonizojnë në sistem të pagave koeficientët ashtu siç janë të lejuar me rregullat aktuale.

### 3.4 Menaxhimi i personelit

Sipas Ligjit Nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës; Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Ligjit mbi të drejtat dhe detyrime Nr.04/L-077 rregullohen çështjet të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin dhe organizimin e personelit. Çështjet e evidentuara janë si në vijim:

---

**Çështja 9 - Dobësi në procedurën e rekrutimit për personelin arsimor**

**E gjetura** Mënyra e përzgjedhjes/rekrutimit të personelit arsimor është e rregulluar me UA mbi “Procedurën e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë”<sup>5</sup>. Bazuar në këtë, ne kemi evidentuar mangësi në përzgjedhjen e mësuesit për shkollën “Ibrahim Rugova”.

Kryetar i komisionit përzgjedhës ishte caktuar drejtori i drejtorisë së arsimit. Kjo paraqet një konflikt interesi, pasi të njëjtit i bëhet rekomandimi për të përzgjedhurin dhe i njëjti bën nënshkrimin e kontratës. Në konkursin e rishpallur, anëtari i tretë i komisionit (drejtori i shkollës) nuk kishte qenë prezent dhe në emër të tij/saj, vlerësimin e kandidatëve e kishte bërë pedagogu i shkollës.

**Rreziku** Anashkalimi i rregullave mbi procedurat e rekrutimit, mund të hap mundësinë drejt favorizimit të kandidatëve të caktuar dhe përzgjedhjes së tyre në mungesë të kriterëve të duhura, e cila në këtë rast mund të ketë efekt negativ në një kategori të ndjeshme, sikurse arsimit fillorë.

**Rekomandimi 9** Kryetari, duhet të rishikojë shkaqet e anashkalimeve të tilla në procedurat e rekrutimit dhe të sigurojë forcimin e kontrolleve në këtë fushë, në mënyrë që procedurat e rekrutimit të zhvillohen konform rregullave të kërkuara.

---

<sup>5</sup> Neni 3, komisioni për zgjedhjen e personelit arsimor përbëhet nga dy përfaqësues të drejtorisë komunale të arsimit (DKA) dhe një drejtor i shkollës, po ashtu personelin arsimor e zgjedh DKA në bazë të rekomandimit të komisionit përzgjedhës.

**Çështja 10 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta (MShV)**

- E gjetura** Komuna për realizimin e shërbimeve të domosdoshme, kishte angazhuar përmes MShV-ve 23 persona. Në pesë rastet e rishikuara kemi vërejtur se zyrtarët ishin angazhuar në kryerjen e punëve për periudhë më të gjatë se gjashtë muaj dhe për ta nuk kishte zhvilluar procedura të rekrutimit. Ky staf ishte angazhuar në kryerjen e detyrave si zyrtarë të ndryshëm, kordinatorë, etj. Një prej tyre ishte duke kryer aktivitetet që nga viti 2014.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave me MShV dhe pa procedura të rekrutimit rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi meritör.
- Rekomandimi 10** Kryetari, duhet të sigurojë se punonjësit me MShV të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se janë marrë në konsideratë me rastin e planifikimit buxhetor, të trajtohen si të nevojshme dhe të diskutohen me MF.

**3.5 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale**

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalit në vitin 2017 ishte 559,741€, kurse buxheti ishte realizuar 92%. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kategori përfshijnë, shpenzimet komunale, derivatet dhe dru për ngrohje, mirëmbajja rutinore, mirëmbajtje e veturave, furnizime pastrimi, etj.

**Çështja 11 - Mos përmbushje e kërkesave të dosjes tenderuese**

- E gjetura** Tek lënda e prokurimit “Furnizim me dru Ahu & Bungu” me vlerë 15,375€, në dosjen e tenderit ishte paraparë që kriter për përzgjedhjen e fituesit, të jenë listat origjinale të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit (2014-2016) si dhe dëshmitë (referenca) për kryerjen e furnizimeve të ngjashme. OE fitues nuk e kishte plotësuar këtë kriter ngase posedonte vetëm një referencë për një projekt të realizuar.
- Rreziku** Mos përmbushja e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit nga ana e OE dhe përzgjedhja e tij fitues nga Autoriteti Kontraktues rrezikon që kontraktuesi mund të mos ketë kapacitetet e duhura për përmbushjen e kontratës.
- Rekomandimi 11** Kryetari, duhet të forcojë kontrollin për të siguruar se kontratat publike nënshkruhen vetëm me operatorët që përmbushin në tërësi kriteret e kërkuara me dosje të tenderit.

### 3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 140,558€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 135,981€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e aktiviteteve kulturore dhe sociale, fermerëve, bursa të studentëve dhe nxënësve, si dhe mbështetje individuale për shërim, etj.

#### Çështja 12 – Ndarja e subvencioneve dhe transfereve

**E gjetura** Në konkursin për përkrahjen e studentëve me bursa për vitin 2017/2018, ishin përcaktuar kushtet dhe kriteret për përfitimin e bursës si dhe ishin përcaktuar fakultetet që kanë përparësi në përzgjedhje. Në mungesë të aplikuesve nga këto fakultete, do të përfitonin studentët që plotësojnë kriteret tjera. Ne kemi vërejtur se nuk janë respektuar kriteret të njëjta për të gjithë aplikuesit, përkatësisht ishin zbatuar standarde të dyfishta. Studenti i Drejtimit Matematikë Financiare<sup>6</sup> i cili plotësonte kriteret tjera nuk ishte shpërblyer me arsyetimin se nuk është drejtim arsimor. Në anën tjetër, studentë nga drejtime jo me përparësi ishin përfitues të bursës.

**Rreziku** Vendosja e standardeve të dyfishta dhe mos respektimi i kriterëve të njëjta për të gjithë aplikantët mund të shpie në keq përdorim të qëllimit të subvencioneve, dhe njëkohësisht dëmton përfituesit tjerë potencial. Përveç kësaj, mund të ndikoj në reputacionin e komunës.

**Rekomandimi 12** Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që bursat ndahen në përputhje me rregullat dhe kriteret e vendosura, në mënyrë që procesi të jetë në dobi të atyre që kanë plotësuar kriteret më të përparëta.

### 3.7 Investimet kapitale

Për vitin 2017, buxheti final i investimeve kapitale ishte 2,028,030€ dhe shpenzimi 1,521,227€ apo 75%. Vitin e kaluar shkalla e realizimit ishte 86%, sidoqoftë krahasuar në shuma absolute, vitin e kaluar kishte projekte kapitale rreth 24% më pak se në 2017. Po ashtu, nga kjo kategori janë ekzekutuar pagesa direkte nga Thesari, bazuar në nenin 39.2 dhe 40 të LMFPP-së, për shpenzime komunale.

<sup>6</sup> Drejtimi Matematikë dhe Informatikë ishte drejtim me përparësi sipas konkursit por jo edhe Drejtimi Matematikë Financiare (edhe pse që të dyja i takojnë Fakultetit të Shkencave Matematiko-natyrore) me arsyetimin se studentët me këtë drejtim nuk mund të angazhohen në mësimdhënie.

---

**Çështja 13 - Mangësitë në përcaktimin e specifikave të mallit**

- E gjetura** Për projektin “Inventar shëndetësor për QKMF Obiliq”, në vlerë 5,930€ njësia kërkuese kishte listuar furnizimet që janë të nevojshme, por ato pozicione nuk përmbanin informata të mjaftueshme të cilat do të mundësonin që inventari të pranohet sipas cilësisë së duhur. Pozicionet ishin përshkruar vetëm si emërtim<sup>7</sup> pa përcaktuar llojin, materialin, dimensionet apo specifiket tjera teknike.
- Rreziku** Specifikimet e pamjaftueshme teknike lënë hapësirë që OE të furnizojë me mall jo cilësor dhe të mos përmbushen kërkesat e caktuara nga njësia kërkuese. Po ashtu, kjo mund të ndikoj që malli i furnizuar të mos ketë vlerën për para.
- Rekomandimi 13** Kryetari, duhet të sigurojë se njësitë kërkuese kuptojnë qartë kërkesat për specifikim teknik të saktë si dhe në rastet e ngjashme, zyrtari i prokurimit duhet të ofrojë këshilla praktike për njësitë kërkuese mbi përmbajtjen e pozicioneve dhe mandej të filloj me proceset e prokurimit.

**Çështja 14 - Mos azhurnimi i duhur i planit për menaxhim të kontratës**

- E gjetura** Në tri kontrata, planet e menaxhimit të kontratës nuk janë plotësuar me informatat e nevojshme dhe ato nuk janë azhurnuar krahas progresit të kontratës siç parashihet me nenin 55.7 të LPP-së. Sipas menaxherëve të kontratës, arsyeja për mos azhurnimin e planeve, është mungesa e informatave dhe trajnimeve për mënyrën e përdorimit të tyre.
- Rreziku** Mos azhurnimi i planit për menaxhimin e kontratës pa mundëson pasqyrimin e një gjendjeje të vërtetë dhe të drejtë të ekzekutimit të punimeve.
- Rekomandimi 14** Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i brendshëm për të siguruar se Plani i Menaxhimit të Kontratës do të azhurnohet me kohë në bazë të përfundimit të punëve.

---

<sup>7</sup> Përshkrimi ishte: orman për kartela shëndetësore, karrige, ulëse për mjek, çarçafë, etj

## 3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

### Çështja 15 – Mangësi në procesin e pagesave

**E gjetura** Sipas Rregullës Financiare 01/2013, neni 22, procesit për inicimin e shpenzimit, i paraprin kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, urdhërblerja, raporti për pranimin e mallit dhe më pas fatura. Po ashtu, pagesa duhet të paguhet brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit. Si pasoj e kontrolleve joadekuate kemi gjetur se:

- Komuna kishte bërë pranimin e punëve/faturave (44,339€<sup>8</sup>) në nëntor të vitit 2016. Derisa pagesat janë bërë me vonesë prej 130 ditë pas afatit ligjor. Arsyeja e bartjes së obligimeve dhe vonesës në pagesë, ishte mungesa e zotimit të mjeteve me kohë;
- Tek furnizimi me material stomatologjik me vlerë 2,643€ dhe material ampular në vlerë 6,001€, urdhërblerja është krijuar pas faturës si dhe pranimi i mallit është bërë nga menaxheri i kontratës dhe jo nga komisioni për pranimin e mallit. Pranimi i mallit vetëm në prezencën e menaxherit ishte bërë edhe për inventarin shëndetësorë me vlerë 5,930€<sup>9</sup>; dhe
- Te pagesa për furnizim me dru për ngrohje në shkolla të ndryshme të komunës, me vlerë 6,000€, pranimi i mallit ishte bërë nga drejtorët e secilës shkollë, pa formuar ndonjë komision për pranimin e tij.

**Rreziku** Hyrja në obligime në mungesë të zotimit të mjeteve, ka shkaktuar bartjen e obligimeve të papaguara në vitin vijues dhe rritë rrezikun e mos përmbushjes së tyre me kohë ndaj OE, ku si pasojë pagesat mund të ekzekutohen direkt nga Thesari dhe të kenë efekt negativ në realizimin e projekteve tjera të planifikuara.

Po ashtu, pranimi i mallit pa urdhër blerje dhe në mungesë të komisionit pranues të mallit, rrezikon pranimin e mallit sipas specifikave të përcaktuara.

**Rekomandimi 15** Kryetari, duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e shpenzimeve, duke siguruar se zotimi i mjeteve bëhet para hyrjes në obligime, dhe faturat paguhet brenda afatit. Po ashtu me rastin e pranimit të mallit të emërohet komisioni përkatës, i cili do të siguronte që mallrat të përputhen në aspektin e cilësisë dhe sasisë me mallrat e kontraktuara.

<sup>8</sup> “Asfaltim i rrugëve rurale dhe trotuareve” në vlerë 29,729€ dhe “Mbjellja e drunjëve dekorativ” në vlerë 14,610€.

<sup>9</sup>Neni 8, pika pesë e rregullores së pasurisë shprehë që komisioni për pranimin e pasurisë jo financiare duhet të jetë në përbërje të jo më pak se tre anëtarë të fushës përkatëse.

### 3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Në fund vitin 2017, vlera neto e pasurive kapitale jo financiare ishte 12,960,601€. Në përgjithësi, komuna ka nevojë për vëmendje të shtuar në menaxhimin kësaj kategorie. Deri në dhjetor të vitit 2017 pozita e zyrtarit të pasurisë nuk ishte e plotësuar për shkak të pensionimit të zyrtarit përgjegjës. Prandaj, përkundër mangësive të prezantuara tek theksimi i çështjes, te opinionin e auditimit, ne kemi shpalosur edhe mangësitë tjera si në vijim.

#### Çështja 16 – Menaxhimi i pasurive kapitale

**E gjetura** Në regjistrin e pasurive gabimisht janë prezantuar pasuri të cilat sipas natyrës janë mallra dhe shërbime, përkatësisht shërbimi për dezinfektim në vlerë 9,750€. Regjistri i pasurive ishte i mbivlerësuar për këtë vlerë.

**Rreziku** Mungesa e informatave të sakta rreth pasurisë, pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Kjo po ashtu shkakton shpalosje jo të saktë të informatave në PVF-të e komunës.

**Rekomandimi 16** Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha drejtoritë bashkëpunojnë në mënyrë efektive me zyrtarin e pasurive për t'i ofruar dokumente të mjaftueshme lidhur me pasuritë e komunës. Me pas Zyrtari i pasurisë duhet të mirëmbajë rregullisht këtë regjistër duke e azhurnuar me të gjitha informatat e kërkuara.

### 3.10 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet përbëhen kryesisht nga: tatimi në pronë, taksa në firmë, hapësirat publike, qiraja komunale, si dhe shitja e banesave dhe ndërrimi i destinimit të tokës<sup>10</sup>.

Vlera e të arkëtueshmeve në fund të vitit 2017 ishte në vlerë 1,064,069€. Komuna në vitin 2017 nuk kishte marrë ndonjë masë për inkurajimin e të gjithë obliguesve të komunës që të paguajnë obligimet e tyre.

<sup>10</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i ka obligime komunës në vlerë 211,759€, në emër të taksës për shpronësim të tokës.

## Çështja 17 - Sfidat në menaxhimin e të arkëtueshmeve

### E gjetura

Në menaxhimin e të arkëtueshmeve janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- Komuna nuk ka të vendosura procedura të brendshme të shkruara lidhur me evidentimin, inkasimin dhe raportimin e të arkëtueshmeve. Komuna mban të regjistruara në Excel shënimet lidhur me pagesat dhe të arkëtueshmet e cila nuk jep siguri të plotë për saktësinë e tyre, ngase të njëjtat shënime në mënyrë manuale barten vit pas viti. Ne nuk kemi mundur të marrim siguri se saldo fillestare e këtyre llogarive është e saktë; dhe
- Prej mostrave të testuara të të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë, kemi vërejtur se një pjesë e konsiderueshme e tyre figurojnë që nga viti 2009. Prej tyre, 11 raste kishin të bënin me borxhet, të cilat rrjedhin nga objektet afariste me vlerë 69,303€.

### Rreziku

Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Mos inkasimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato të bëhen të pa mbledhshëm duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për komunën.

### Rekomandimi 17

Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Po ashtu komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një softueri për menaxhimin e tyre.

## 3.11 Obligimet e papaguara

Komuna ka deklaruar obligime ndaj furnitorëve vlerën prej 122,751€, shumë kjo më e ulët për 33% krahasuar me vitin 2016. Derisa në lidhje me pretendimet e palëve tjera ndaj komunës, në bazë të kontesteve aktuale gjyqësore, komuna ka listuar disa raste të mundshme me një shumë të vlerësuar prej 1,439,073€. Vlen të theksohet se detyrimet kontingjente janë rritur konsiderueshëm për 903,529€. Kjo, si rrjedhojë e padive që kishin të bënin me kompensim dëmi nga vitet e mëhershme 1999-2004.

Komuna zbaton një proces relativisht të rregullt të raportimit të obligimeve. Drejtoritë në përgjithësi janë të vetëdijshme për kërkesat e rregullores për raportim të faturave të papaguara si dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në Thesar në lidhje me këtë.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Obiliqit ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i AP-së dhe progresi i zbatimit të Planit të Veprimit për rekomandimet e dhëna, nuk është diskutuar në Asamblenë Komunale.

Nga rekomandimet e dhëna për vitin 2016, shtatë rekomandime janë zbatuar; tri ishin në proces dhe nëntë nuk janë adresuar ende. Nga viti 2015 ishin bartur 15 rekomandime, prej tyre katër janë zbatuar në vitin 2017, dy nuk ishin zbatuar dhe shtatë të tjera ishin në zbatim e sipër. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

### Çështja 18 - Nivel i ulët në zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

**E gjetura** Komuna, ka bërë progres të kufizuar në adresimin e rekomandimeve pasi që vetëm disa nga rekomandimet e vitit të kaluar janë zbatuar plotësisht. Komuna, nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Për më tepër, Plani i Veprimit për rekomandimet dhe progresin e tyre, nuk kanë arritur ta diskutojnë në Asamblenë Komunale.

Si pasojë, rekomandimet e pa zbatuara si: niveli i ulët i ekzekutimit të buxhetit të investimit kapitale, regjistri i pasurive jo i plotë, mungesa e regjistrimit të rreziqeve, mungesa e Komitetit të Auditimit (KA) dhe niveli i lartë i të arkëtueshmeve, janë të gjetura të përsëritura në raportet e auditimit në tri vitet e fundit.

Po ashtu, edhe për rekomandimin e vitit të kaluar lidhur me lokalet të cilat ndodhen në objektin "D" dhe "GJ" e që shfrytëzohen nga partitë politike dhe nga bizneset private, nuk ishte marrë asnjë veprim nga komuna në drejtim të dhënies së lejes për shfrytëzim.

**Rreziku** Përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm përderisa rekomandimet e dhëna nuk adresohen.

**Rekomandimi 18** Kryetari, duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, me fokus fillestar në fushat e një rëndësie më të madhe. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.

---

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në lidhje me qeverisjen e mirë vlerësojmë progresin që ka bërë komuna në lidhje me iniciativat për përpilimin e listës së rreziqeve për vitin 2018 dhe raportimet e rregullta financiare. Megjithatë, ekzistojnë disa mangësi sa i përket qeverisjes brenda komunës, veçanërisht në lidhje me mos zbatimin e plotë të rekomandimeve nga viti paraprak, realizimin e buxhetit dhe kontratat e nënshkruara, dhe iniciativa modeste për mbledhjen e të hyrave.

Sipas Ligjit për planifikimin hapësinor planifikimi i nivelit lokal bëhet përmes tri dokumenteve, si: Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe planet Rregulluese të Hollësishme.

Komuna gjatë vitit 2017 kishte përfunduar Hartimin e Strategjisë për Zhvillim Socio Ekonomik lokal 2017-2021, Planin Zhvillimor Komunal 2016-2025 dhe i njëjti e kishte të llogaritur koston për zbatimin e saj. Po ashtu komuna ka hartuar grupin për fillimin e hartimit të Hartës Zonale si dokument fillestar për krijimin e strategjisë, pas së cilës do të duhej të krijohet Plani i Ri Zhvillimor Komunal.

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) gjatë vitit 2017 kishte operuar me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Aktualisht është vetëm një auditor, ngase drejtori ka shfrytëzuar të drejtën e pensionimit të parakohshëm. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

### Çështja 19 - Sfidat në sistemin e Auditimit të Brendshëm

**E gjetura** Mangësitë në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, janë:

- NjAB kishte arritur të finalizojë gjashtë<sup>11</sup> auditime nga shtatë që kishte planifikuar të cilat nuk mbulonin periudhën aktuale, mirëpo ishin të fokusuara vetëm në aktivitetet e periudhës paraprake, 2016; dhe
- NjAB, kishte dhënë gjithsej 34 rekomandime se si menaxhmenti të përmirësoj funksionimin e kontrollit të brendshëm, mirëpo njësitë që kanë qenë subjekt i auditimit nuk kanë përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve, përveç raportit të fundit (Auditimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale).

Këto çështje mund të jenë evidente edhe si pasojë e mungesës së Komitetit të Auditimit (KA), të cilin komuna ende se ka themeluar.

### **Rreziku**

Ndjekja e ngjarjeve nga auditimi pasi ato të kenë ndodhur nuk i shton vlerë përmirësimit të gjendjes dhe parandalimit të gabimeve që mund të rrjedhin nga komuna. Derisa mos krijimi i KA dhe mos zbatimi i rekomandimeve të AB-së, ndikon që niveli i kontrolleve të brendshme të mos përmirësohet dhe rrit rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të vazhdojnë të përsëriten, duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje financiare.

**Rekomandimi 19** Kryetari, duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së dhe të marrë të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar, derisa themelimit të KA duhet t'i jepet rëndësi e veçantë.

<sup>11</sup> Raportet për vitin 2016: Menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve, Rishikimi i proceseve të subvencioneve, Procesi i Prokurimit, Menaxhimi i pasurisë dhe inventarit, Rishikimi i proceseve të donacioneve dhe Auditimi i të hyrave dhe shpenzimeve në DSHMS për vitin 2017.

---

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara kanë nevojë për forcim në mënyrë që të mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 20 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**E gjetura** Si pasojë e kontrolleve jo të mira menaxheriale, shuma të konsiderueshme të buxhetit për investime kapitale nuk janë shpenzuar dhe numër i madh i pagesave ishin bërë në tremujorin e fundit të vitit. Po ashtu menaxhimi i të arkëtueshmeve nuk ishte në nivelin e duhur. Menaxhmenti duhet të bëjë analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, të rishqyrtojnë planin e prokurimit si dhe arkëtimin e të hyrave.

Sipas rregullave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, komuna duhet të ketë një sistem për menaxhim të rreziqeve. Për vitin 2017 ky sistem nuk ishte vendosur për tu paraparë edhe veprimet monitoruese për mbikëqyrjen e aktiviteteve për menaxhimin e rreziqeve.

**Rreziku** Kërkesat jo të forta të llogaridhënies dhe raportimi financiar duhet të forcohen për të ndikuar në efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

**Rekomandimi 20** Kryetari, duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj strategjinë për menaxhimin e rrezikut me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI)

### *Forma e opinionit*

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### *Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit*

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### *Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit*

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rrezikut domethënës lidhur me plotësinë e pasurive e që mund të rezultoj me Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale. Ky proces duhet të monitorohet formalisht nga Kryetari i Komunës.			Nuk janë marrë masa.
1. Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse në draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të shqyrtoj pse plani i veprimit për vitin e kaluar nuk është zbatuar, si dhe në planin e implementimit për vitin 2015 të përcaktoj saktë afatet kohore për adresim të rekomandimeve të bëra nga AP dhe stafin përgjegjës, me fokus fillestar në çështjet më të rëndësishme të ngritura nga auditimi.		Është përgatitur dhe dorëzuar plani i veprimit, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve është shumë i ulët.	

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të trajtoj si çështje urgjente hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse ku duhet të përcaktohen objektivat zhvillimore të përcjellura me burimet e kërkuara për realizimin e saj. Ai gjithashtu duhet të siguroj se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Auditimi i brendshëm duhet të aplikoj një proces rishikimi për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të siguroj raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të siguroj se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.		Mbahen procesverbale të takimeve të bordit të drejtorëve, mirëpo duhet të behet raportim formal lidhur me anën financiare.	



2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj themelimin e Komitetit të Auditimit për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm. KA fillimisht duhet të siguroj që NjAB ka të gjitha burimet e nevojshme për kryerjen e një auditimi të pavarur dhe efektiv. KA, po ashtu, duhet të rishikoj në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofroj sigurinë e kërkuar menaxhmentit mbi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e kontrolleve. Gjithashtu, duhet të rishikoj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore rishikohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Këtij aktiviteti duhet t'i paraprijë një proces i mirëfilltë i planifikimit, përcaktimit të objektivave dhe ndërlidhjes së tyre me buxhetin e komunës.		Realizimi i buxhetit ne total është i pranueshëm 91%, mirëpo tek investimet kapitale realizimi është i ulët.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim i brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha prokurimet e zhvilluara. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrolle të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuara do të adresohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore gjatë vitit 2016.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj aplikimin e kërkesave të Rregullës Financiare nr. 01/2013/MF - mbi shpenzimet e parasë publike me rastin e shpenzimeve pa prokurim, duke forcuar kontrollet për pagesat e bashkëfinancimeve. Gjithashtu, pagesat tjera duhet mbështetur me dëshmitë që arsyetojnë qëllimin zyrtar të shpenzimit dhe të monitorohen që nga fillimi i procedurave.	Po		

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet të siguroj një paralogaritje të bazuar në analiza reale për të hyrat e komunës para propozimit për aprovim nga Kuvendi Komunal. Ky proces duhet të përfshijë të gjitha të hyrat potenciale të komunës duke përfshirë edhe ato nga shpronësimi i pronave komunale.		Niveli i realizimit ka arritur në 86% të të hyrave të planifikuara.	
3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet t'i forcoj kontrollet për dhënien dhe inspektimin e lejeve ndërtimore dhe të siguroj zbatimin e procedurave dhe angazhimin e stafit profesional sipas kërkesave ligjore.	Po		
3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari duhet të siguroj një planifikim adekuat të të hyrave nga tatimi në pronë dhe të vendos kontrolle mbi verifikimin e pronave më qellim të ngritjes së realizimit të të hyrave nga ky burim dhe arritjen e objektivave komunale.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të siguroj një proces efektiv të regjistrimit të të gjitha pasurive, duke përcaktuar rolet kyçe, që në këtë proces mund të ketë Drejtoria e Kadastrit, duke mbledhur dhe raportuar të gjitha të dhënat mbi pronat në posedim të komunës. Më pas, një komision i veçantë duhet të bëjë një vlerësim të pasurive të identifikuara dhe, pas rishikimit kritik nga ana e Kryetarit, një raport t'i dorëzohet zyrtarit të pasurive për t'i proceduar regjistrimet e duhura në SIMFK (moduli i pasurive). Gjithashtu, komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive duhet të krijohen çdo vit në kohë adekuate që të kryhet inventarizimi i tërësishëm për të konfirmuar ekzistencën e pasurive (në veçanti të pasurive të luajtshme). Të gjitha aktivitetet duhet të kryhen para se PVF-të e vitit 2016 të jenë dorëzuar në MF.			Nuk janë marrë masa.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet t'i analizoj arsytet e nivelit të lartë të të arkëtueshmeve dhe t'i forcoj kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të prezantohen për të mundësuar mbledhjen e të arkëtueshmeve historike, përfshirë edhe veprimet ligjore.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i borxheve (detyrimeve)	Kryetari duhet t'i forcoj kontrollet menaxheriale duke siguruar një planifikim të hollësishëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Për trajtimin e borxheve të akumuluar, Kryetari duhet të paraqes një plan ku parashihen veprime konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të komunës. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet direkt nga Kryetari i Komunës.	Po		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e përgatitjes së PFV, është kompletuar dokumentacioni i nevojshëm për procesim të shumave të pranuar nga palët e treta në pasqyra si dhe në modulën përkatës në SIMFK, regjistri i pasurive të jetë i plotë, duke përfshirë edhe tokat në pronësi komunale, dhe zërat që nuk përmbushin kriteret e pasurisë, duhet të largohen nga regjistrat. Kryetari duhet të siguroj se gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së ZKF-së. Gjithashtu, para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato duhet t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre, me theks të veçantë tek regjistrimi i pagesave nga palët e treta dhe shpalosjet e informatave tjera.			Nuk janë marrë masa.


2.1 Zbatimi i rekomandimeve	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse një numër rekomandimesh nga viti i kaluar nuk janë zbatuar, si dhe të siguroj që plani i veprimit i përgatitur pas marrjes së këtij raporti, do të inkorporoj të gjitha rekomandimet e dhëna dhe do të përcaktoj saktë afatet kohore, masat dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve. Për ta përmirësuar procesin, raportet e progresit në zbatimin e rekomandimeve duhet të shqyrtohen çdo tremujor dhe mekanizmi i llogaridhënies duhet të vendoset.		Është përgatitur dhe dorezuar plani i veprimit, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve është shumë i ulët.	
2.2 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të trajtoj si çështje me prioritet finalizimin e strategjisë gjithëpërfshirëse, regjistrin e rreziqeve, të siguroj që pasi të jetë hartuar regjistri i rreziqeve, është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtues përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive tjera do ta menaxhoj këtë proces dhe të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk janë marrë masa.
2.3.1 Mungesa e planeve strategjike	Kryetari duhet të siguroj finalizimin e draft planeve strategjike, si dhe hartimin e planeve operative si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së rezultateve kundrejt objektivave dhe të vendos funksione efektive të mbikëqyrjes.	Po		
2.3.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se cilësia e kontrolleve menaxheriale dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrole të përshtatshme, në fushat ku janë identifikuar dobësitë.		Në proces, mbahen takime çdo javë si dhe ka procesverbale. Mirëpo, çështjet e ngritura në raport ende tregojnë dobësitë e shfaqura dhe jo të analizuar në raportimet e bëra.	

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të fuqizoj bashkëpunimin me auditimin e brendshëm përmes identifikimit të fushave më të ndejshme për auditim, bazuar në nivelin potencial të rrezikut, si bazë për hartimin e planit vjetor të punës. Më pas, duhet të rishikoj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Themelimi i Komitetit të auditimit, gjithashtu duhet të jetë çështje që duhet shqyrtuar brenda një periudhe të arsyeshme.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që zyra e tatimit në pronë ka burime të mjaftueshme për të përfunduar procesin e verifikimit vjetor të pronave më qëllim të përmbushjes së detyrimit ligjor, në njërën anë, dhe ngritjes së realizimit të të hyrave nga ky burim, në anën tjetër.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se proceset për qiradhënie të shoqërohen me përcaktimin e kriterëve të qarta për ofertuesit e interesuar, në mënyrë që komuna të nxjerrë përfitimet maksimale nga dhënia me qira e hapësirave publike.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që shfrytëzuesit e lokaleve komunale, të pajisen me kontrata ku do të përcaktoheshin në mënyrë specifike të gjitha kushtet e shfrytëzimit, kohëzgjatja, afatet për kryerjen e pagesave, dhe kushtet e mirëmbajtjes së objektit.			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Pagat dhe medijtjet	Kryetari duhet të siguroj se bëhet një rishikim nga drejtoria e arsimit, për mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret për t'i pajisur me kontrata me afat të pacaktuar të gjithë stafin arsimor të cilët i përmbushin kushtet ligjore.	Po		

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të siguroj se për të gjitha aktivitetet që nevojiten procedura të prokurimit, të zhvillohen procedurat përkatëse, në mënyrë që të sigurohet transparencë e procesit dhe çmimet më të përshtatshme që ofron konkurrenca.		Pjesërisht, çështjet e përmendura në rekomandim nuk janë përsëritur, megjithatë, në këtë vitë, janë shfaqur dobësi në vlerësimet e ofertave.	
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të siguroj se shpenzimi i fondeve të bëhet në përputhje me ndarjet fillestare të buxhetit, dhe në rast të devijimeve të tilla, shpenzimet duhet të prezantohen dhe shpalosen në përputhje me kërkesat ligjore, për një pasqyrim të drejtë në raportimet financiare.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që për asnjë projekt të mos lejoj ekzekutimin e punimeve para se të hartoj projektet ekzekutive, si dhe të forcoj kontrollet e mbikëqyrjes dhe të zgjidhë të gjitha çështjet që mund të reflektojnë në vonesa të ekzekutimit të projekteve.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se para se të filloj ekzekutimin e projekteve, do të zotoj fondet e duhura për secilin projekt dhe se nuk do të rrezikoj realizimin e projekteve të planifikuara me Planin vjetor të prokurimit.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të merren të gjitha masat e kontrollit që marrëveshjet e bashkëfinancimit, përfshirë kërkesat e qarta të raportimit, do të zbatohen dhe monitorohen në pajtim me kërkesat kryesore të marrëveshjeve.	Po		

3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të aplikoj kontrole shtesë në mënyrë që pagesat të jenë në harmoni me rregullat financiare, përkatësisht Urdhërblerja të krijohet dhe përgatitet nga ana e organizatës buxhetore sipas kërkesave të parapara.			Nuk janë marrë masa.
3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj një regjistër të saktë të pasurive, që zyrtari i pasurisë para se të bëjë regjistrimet e duhura, të sigurohet se plotësohen kriteret sipas rregullores për regjistrim në pasuri, si dhe të sigurohet funksionalizimi i sistemit e-pasuria në gjithë komunën. Komisioni për inventarizim të siguroj një raport përmbledhës për rezultatet e inventarizimit. Lista e vlerësimit të pronave komunale të rishikohet dhe të gjitha pronat kontestuese të hiqen nga lista. Pasi që procesi të jetë kompletuar, të gjitha regjistrimet të azhurnohen në regjistrat kontabël të pasurive.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Trajtimi LLA	Kryetari duhet t'i analizoj arsyet e nivelit të lartë të arkëtueshmeve dhe t'i forcoj kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Një strategji dhe mekanizma adekuat duhet të prezantohen për të mundësuar raportimin e saktë të tyre si dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve historike, përfshirë edhe veprimet ligjore.			Nuk janë marrë masa
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat e pranuar procedohen për pagesë brenda afatit të paraparë me rregullën e thesarit nr. 02/2013, si dhe të sigurohet një menaxhim më i mirë dhe më efikas për nevoja të raportimit.	Po		


## Shtojca III: Letër Konfirmimi

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlasna  
Nr. 11-519 Data 11.06.2018  
Br. 11.06.2018 Datum

 OBILIQ-OBILIC

Republika e Kosovës-Republika Kosovo- Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obiliq



**LETËR E KONFIRMIMIT**


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhafer Gashi..... 

Kryetar i Komunës së Obiliqit,

Data: 11.06.2018 Obiliq,

